Kosova cilësohet si vend me larmi të theksuar të tipareve natyrore, si: ndërtim gjeologjik, relief, kushte klimatike, hidrografi dhe botë e gjallë bimore dhe shtazore, të cilat kanë ndikuar në krijimin e vlerave të trashëgimisë natyrore. Duhet të theksojmë se Kosova, me natyrën e saj të larmishme dhe interesante, ka shumë vlera të trashëgimisë natyrore që meritojnë statusin kombëtar dhe ndërkombëtar të mbrojtjes si trashëgimi botërore. Turizmi kosovar prej fillimit është bazuar në mundësitë reale të zhvillimit të llojeve turistike, të cilat janë karakteristike për turizmin kontinental. Karakteristikat atraktive të faktorëve natyrorë dhe antropogjenë janë mjaft të ndërlikuara, ndaj ndarja e tyre tipologjike paraqet në veçanti problem në vete, kryesisht faktorët natyrorë, pikë së pari, paraqesin dukuri të ndryshme natyrore: dukuri morfologjike (male, lugina, gryka, kanione dhe shpella), dukuri hidrografike (lumenj, liqene, burime termominerale) si dhe dukuri iogjeografike (bota bimore dhe shtazore). Si dukuri të rrallë morfologjike kemi Shpellën e Gadimes, shpellë e mermerit, e njohur jo vetëm në Kosovë, por edhe në rajon e më gjerë. Shpella e Gadimes gjendet në fshatin Gadime në afërsi të Lipjanit, Kosovë. Ajo është e gjatë 1500 metra, mirëpo për turistët është i mundshëm shikimi i vetëm 1300 metrave të para të shpellës, pasi që për pjesën tjetër të shpellës ende nuk janë të mundshme kalimet. Në shpellë gjenden: kati i mesëm që është për vizitorë, kati nënujor dhe kati i sipërm. Gjatë verës temperatura në brendi të shpellës është konstante 13 gradë celsius dhe gjatë dimrit 11-13 gradë. Janë të rregulluara afro 2000 metra katrorë. Shpella i ka dy kate, nga të cilat, i dyti, nuk është rregulluar ende për vizitorë. Uji atmosferik, kur bie në kontakt me ajrin përmes çarjeve të ndryshme tektonike, avullohet e pastaj bëhet kondensimi i bikarbonatit të kalciumit dhe formohen stalaktite dhe stalagmite. **E vetmja shpellë e mermerit në Evropë...**E bukur dhe mistike, një nga pasuritë më të veçanta të Kosovës, çdo gjë e natyrshme është tërheqëse. Kush di t'i vlerësojë, i ruan e kush jo, i shkatërron ato. Mbijetesa e saj varet nga dora e njeriut. Ndaj, nuk do të duhej të vinte në shprehje thënie indiane: "Dikur njeriu i është frikësuar natyrës, ndërsa sot natyra i frikësohet njeriut".

Fjalë kyç: monument natyre, menaxhim, resurse natyrore, shpellë, shfrytëzim.

¹ Prof. asst. dr. Hysen Sogojeva, Fakulteti i Shkencave të Aplikuara, Universiteti i Ferizajt/Faculty of Applied Sciences, Ferizaj University, Ferizaj, Kosovo: hysen.sogojeva@gmail.com

Rrugëtimi i Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian: Sfidat, identiteti dhe patriotizmi

Ilda Budlla¹

Ballkani Perëndimor, por veçanërisht Shqipëria dhe Kosova, si një rast unik i një kombi të ndarë në dy shtete, u ka mbijetuar furtunave të egra të historisë, aleancave keqdashëse, tradhtise dhe luftës, ama në këtë rrugëtim të vështirë kanë arritur të ruajnë identitetin për të cilin kanë derdhur gjak mijëra luftëtarë. E për këtë identitet të ruajtur me kaq fanatizëm lëshohen fjalime propagandistike, sipas së cilave ky identitet na qenka kinse anadollak (oriental) me një përpjekje për t'u dukur modern e perëndimor. Duke ditur se populli dëshiron më së shumti aderimin në BE, politika e këtyre vendeve ka ditur mjaft mirë ta shfrytëzojë këtë fakt, ndaj në axhendën politike të qeverisë dhe atë elektorale, aderimi në BE mbetet premtimi dhe prioriteti strategjik i tyre. Ajo që duhet përmendur, është fakti se anëtarësimi në BE nuk është thjesht një vendim, një gjendje statike, përkundrazi, i gjithë procesi është progresiv dhe dinamik. Në këtë rrugëtim të gjatë prej dekadash tashmë, cila është arsyeja pse Ballkani Perëndimor vazhdon të mbetet kaq larg ëndrrës evropiane?! Në këtë marrëdhënie dypalëshe, cila prej tyre po përfiton nga tjetra dhe po bëhet kaq i vështirë ky proces? A thua vendet e Ballkanit Perëndimor dhe qeveritë e tyre nuk po punojnë mjaftueshëm për të përmbushur kushtet e vendosura? Apo mos vallë BE-ja ka hequr dorë nga politika e zgjerimit meqë edhe vetë nuk po mundet të menaxhojë ato vende që janë pjesë e unionit, duke kujtuar kështu Brexit? E nëse është kjo, pse atëherë vazhdon e hedh "shashka" shprese, apo mos vallë ka ende frikë, duke qenë se Ballkani Perëndimor, pavarësisht përpjekjeve, mbetet një fuçi baruti që mjafton një shkëndijë për ta plasur, e po përdor manovra diplomatike për ta mbajtur nën kontroll. Aderimi në BE nuk nënkupton vetëm lëvizjen e lirë, ajo nënkupton një shtet të së drejtës, demokraci liberale, ndërkohë në Ballkanin Perëndimor korrupsioni merr jetë, betonizimi lartësohet, ndërtimi merr dhenë, flora dhe fauna shkatërrohet, papunësia rritet, çmimet kalojnë çdo limit, arsimit krijon analfabetë funksionalë dhe truri i vertetë merr dhe e ikën. Ku po shkojmë??? Përpara se të na duan të tjerët, ne duhet të duam veten, sepse vetëm kështu do të arrijmë të ecim përpara...

Fjalë kyç: Ballkani Perëndimor, sfida, identiteti, Bashkimi Evropian, integritet.

¹ Ma. Ilda Budlla, Fakulteti i Ekonomisë/Faculty of Economics, University of Tirana, Albania:
Ilda.Budlla@gmail.com

Pasqyrimi i sferës publike evropiane në mediet kombëtare

Ilire Zajmi¹ dhe Zija Rexhepi²

Kosova, shteti më i ri në Europë, synon të integrohet në Bashkimin European, ashtu si vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor: Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Serbia e Mali i Zi. Në procesin e rrugëtimit drejt Europës, mediet luajnë një rol të rëndësishëm, duke i krijuar më shumë hapësirë raportimit mbi çështjet dhe temat evropiane. Mediet kombëtare, përveçse si përçuese të informacionit, krijojnë opinion rreth këtyre çështjeve, duke kontribuar kështu në krijimin e sferës publike evropiane. Ky punim analizon e krahason “europianizimin” e medieve kombëtare në Kosovë dhe Shqipëri dhe trajton sesi ato sjellin informacionet për Europën. Punimi trajton informacionet e postuara online në faqet zyrtare të transmetuesve publikë kombëtarë në Kosovë dhe Shqipëri: Radiotelevizioni i Kosovës RTK dhe Radio Televizioni Shqiptar RTSH. Analiza e informacioneve është fokusuar te transmetuesit publikë për shkak të besimit që gëzojnë në opinion. Rezultatet tregojnë se informacione e përmbajtje të bollshme mbi Europën janë të pranishme në faqet online të dy medieve publike. Ky punim synon të çojë më tej debatin mbi këtë temë, duke theksuar marrëdhënien e drejtpërdrejtë midis medias dhe pasqyrimit të temave e çështjeve që lidhen me Europën.

Fjalë kyç: Europë, europianizim, medie, sferë publike, online, raportim, informacion.

¹ Dr. Ilire Zajmi –Rugova, Fakulteti i Komunikimit Masiv/Faculty of Mass Communication, AAB College, Prishtina, Kosovo: ilire.zajmi@aab-edu.net

² Zija Rexhepi, Prorektor për për administratë dhe marrëdhënie me publikun/Vice Rector of Administration and Public Relations, AAB College, Prishtina, Kosovo: zija.rexhepi@aab-edu.net

Kosovo's national disability education policies and their alignment with the European Disability Strategy

Ilirjana Geci¹

The aim of this study is to investigate the disability educational policies of Kosovo, and their alignment with the European Disability Strategy. In the framework of the Strategy for the Rights of Persons with Disabilities in Europe 2021-2030, adopted by the European Commission in March 2021, quality education is a prerequisite for succeeding in the labour market. Therefore, equal access to education should be ensured for all children, at all levels of European society, in line with the United Nations Convention on the Rights of Persons with Disabilities. Kosovo, as a country that aspires European Union integration, is working to align its education disability policies with the EU *acquis* as required in the Stabilisation and Association Agreement between Kosovo and EU. Desk research was utilized as a method to generate data that compare the national and European educational disability policies. Legal documents and reports that reflect the implementation of the educational disability policies, both at national and European level, were analysed and compared. Findings suggest that Kosovo has worked rapidly to reflect the European educational policies in the national level, especially with the adoption of the National Strategy on the Rights of Persons with Disabilities in Kosovo 2013/23, The Law No 04/L-032 on Pre-University Education in Kosovo, and the Administrative Instruction on the Pedagogical Assessment of Children with Special Needs. However, the practical aspect and the real experience of people, as reflected in relevant monitoring reports, have encountered significant transformation difficulties.

Keywords: Disability, Education, Policies, Kosovo, European Union.

¹ Ilirjana Geci, PhD Cand., Fakulteti i shkencave sociale/Faculty of Social Sciences, AAB College, Prishtina, Kosovo: ilirjana.geci@aab-edu.net

Edukimi i vlerave identitare nacionale dhe qytetarisë në kurrikulën shkollore në Republikën e Shqipërisë

Irgen Xhyra¹

Sistemi arsimor shqiptar gjithmonë e më shumë po vihet nën presionin e ruajtjes së një ekuilibri mes europianizimit, modernizimit dhe përshtatjes së kurrikulave shkollore me ato europiane. Kjo është pasojë e drejtpërdrejtë e dy faktorëve: së pari, nevojës së përshtatjes së kurrikulës arsimore me realitetin europian dhe së dyti, detyrimeve ligjore, të cilat rregullojnë sistemin arsimor në Republikën e Shqipërisë. Sa i përket përshtatjes me realitetin europian, problemi që shtrohet është i lidhur ngushtë si me përshtatjen me tregun e punës, ashtu dhe me edukimin e vlerave politike, kulturore, shoqërore dhe ekonomike, të cilat qëndrojnë në thelb të identitetit europian. Ndërkohë, ligji që rregullon arsimin në Republikën e Shqipërisë njeh dhe e bën të detyrueshme parashikimin e edukimit të vlerave kulturore, sociale, ekonomike, pse jo edhe politike, të cilat përbëjnë thelbin e identitetit kombëtar shqiptar. Në kushtet e një ekuilibri të tillë duhet që të ketë një raport të drejtë mes edukimit të vlerave europiane dhe atyre nacionale. Në këtë rrafsh do të analizojmë se si shfaqen në mënyrë sasiore dhe cilësore në programet në zbatim në Republikën e Shqipërisë, edukimi i këtyre vlerave në sistemin arsimor shqiptar. Po kështu, do të evidentojmë dhe problematikat që hasen në zbatimin e parimeve mbi të cilat duhet të ngrihen këto programe dhe kurrikula.

Fjalë kyç: arsim, histori, kornizë kurrikulare, qytetari, identitet kombëtar e europian.

¹ Ma. Irgen Xhyra, Gjinnazi gjuhësor/high school “Mahmud e Ali Cungu”, Elbasan, Albania: irgen.xhyra@gmail.com

Identiteti kombëtar i trajtuar në tekstet e qytetarisë para dhe pas viteve '90 në Shqipëri

Nada Kallçiu¹ & Fatmira Mulliçi²

Ky studim paraqet si është trajtuar identiteti kombëtar në periudhën e komunizmit në tekstet shkollore krahasuar me atë pluraliste. Qëllimi i këtij hulumtimi është analiza krahasuese e identitetit kulturor në tekstet mësimore të lëndës së qytetarisë. Punimi është realizuar përmes metodës cilësore të kërkimit shkencor, intervistës gjysmë të strukturuar. Kampionimi është i qëllimshëm dhe intervistat janë realizuar me pesë specialistë, drejtues e mësues aktualisht në pension dhe dhjetë të tjerë që punojnë në arsimin parauniversitar. Rezultatet tregojnë se në programet mësimore të lëndës së qytetarisë para viteve '90 nuk janë trajtuar nënkulturat dhe identiteti kombëtar i krahinave shqiptare dhe sidomos kultura e popullsisë shqiptare e mbetur jashtë kufijve të shtetit shqiptar. Boshllëqet në formimin kulturor kombëtar u vunë re pas viteve '90 dhe sidomos në vitet e luftës së Kosovës e shpalljes shtet i pavarur, atëherë kur lëvizja e popullsisë u bë e lirë, por mungesa e njohjes së njëri-tjetrit në identitetin kulturor reflektoi në një hap të ngadaltë integrimi. Kjo çështje e mungesës së njohjes së identitetit kombëtar nga populli shqiptar duhet të vërë në lëvizje të dy shtetet shqiptare në hartimin e politikave kulturore e arsimore në kontekst të vlerave kombëtare. Ministrinë e Arsimit në Shqipëri e Kosovë rekomandohen të hartojnë strategji arsimore, module shkollore e projekte të përbashkëta. Mësuesit dhe specialistët e arsimit duhet të jenë pjesë e një të tërë në trajnimin profesional në tematikën e kulturës e multikulturës.

Fjalë kyç: kulturë, komb, identitet, multikulturë, tekst qytetarie.

¹ Dr. Nada Kallçiu, Faculty of social sciences, University of Tirana, Albania: nkallciu@gmail.com

² Msc. FatmiraMulliçi, teacher, Junior High School "Hamza Muça," Tirana, Albania: mmira@live.com

The multiplicity of architectural identities; Space and Matter, and forms of transformation

Kaltrina Jashanica¹

As architecture oscillates in a strict scalar possibility that concerns the mechanisms of human perception, its transitive character of matter and progressive loss of its mass reveals many moments of involution regarding constructive consciousness of the architectural built. In this regard, due to the plurality of influential fonts, its relation to the identity of the place is in constant interrogation. The study consists in research of new spatial configurations and matter of architectural interpretation which assist the ambiguous character of the place beyond its perceptive mien. Considering the new materiality and beyond, since '90s, architecture encountered a suspended quality of noble materials as a means to discover a new architecture through, compatible with nature or/and new spatial configurations on the way. The result, new surfaces, new architectural programs and consequently new *character*. Today, intellectual, experiential qualities and profound ideas are clustered within technological expressive means, thus as a meditation of formal qualities primary to matter itself. "Yet, architecture is a true co-presence of meaning and material" (P. Emmons). As a consequence, the metaphor of time and matter lies in the mediation of what is perceived and the reality of construction as altered to the extent of phenomenal reasoning, vis-à-vis to the built of ambiguous identities. The study inclines the argument through few geographic areas with the aim to reassess how the above-mentioned conditions constrained architecture to be 'compromised' to new spatial conditions and requirements.

Keywords: transposition, matter, phenomenology, spatiality, contemporary

¹ Dr. Kaltrina Jashanica, Sapienza Università di Roma, Italy/AAB College, Prishtina, Kosovo: kaltrina.jashanica@aab-edu.net

Avancimi dhe perspektiva e integritit të Kosovës në Bashkimin Evropian

Mustafë Kadriaj,¹ Gurakuç Kuçi² & Kastriot Veselaj³

Procesi i integritit të Kosovës në Bashkimin Evropian është një proces deri diku i pandashëm me vendet e Ballkanit Perëndimor dhe me një rëndësi të përmbushjes së proceseve historike, gjeopolitike dhe ekonomike. Ky është një konkluzion i dalë nga ky punim, i cili trajton aspektet historike, ekonomike dhe politike të rëndësisë së integritit të Kosovës në BE. Nga aspekti historik ky punim trajton periudhën e bashkëpunimit ndërmjet Kosovës dhe BE-së që nga lufta e fundit në Kosovë e gjer më sot, për të vazhduar me pjesën ekonomike, e cila tregon perspektivën që ofron BE-ja si tani që Kosova nuk është vend anëtar, por edhe në të ardhmen me anëtarësim. Në aspektin politik, kjo temë përfshin analizimin e rëndësisë së proceseve të cilat kanë ndodhur tani, së bashku me shpjegime gjeopolitike, ku përfshihet edhe një pjesë analitike mbi atë që quhet “modernizim”. Të tria këto aspekte që trajtohen në punim, përfundojnë me konkluzione të cilat ofrojnë edhe rekomandime mbi atë që mund të shpresojmë, sipas terminologjisë së Kantit, “paqen e përhershme”. Pra, hulumtimi mundohet të tregojë se sa afër dhe larg është Kosova me BE-në dhe për këtë arsye e kemi përdorur edhe metodën interdisiplinare për studim. Pyetja hulumtuese e punimit është: “Sa afër dhe larg integritit në BE është Kosova?” Hipoteza e punimit është: “Integrimi i Kosovës në BE është i lidhur shumë me një integrit të të gjithë Ballkanit Perëndimor, por mundësitë e Kosovës për hapa më të avancuar varen nga shfrytëzimi i përparësive në stabilitetin e shtetndërtimit dhe përafrimit me perëndimin si partnerë, dhe jo duke u bërë barrë për perëndimin ose duke u varur nga stabiliokracia”.

Fjalë kyç: Ballkani Perëndimor, integrimi në BE, Kosova, stabiliokracia, modernizimi.

¹ Prof. ass. dr. Mustafë Kadriaj, Kolegji Biznesi/Business College, Prishtina, Kosovo: mustafkadriaj@live.com,

² Dr. Gurakuç Kuçi, drejtor / Director “Independent Institute for Political and Media Studies”, Prishtina, Kosovo: gurakuçkuçi@gmail.com

³ Ma. Kastriot Veselaj, PhD Cand, University of Pristina “Hasan Prishtina”, Prishtina, Kosovo: kastriot.veselaj@uni-pr.edu

Rëndësia e anëtarësimit të Republikës së Kosovës në Organizatën Ndërkombëtare Policore INTERPOL

Kenan Idrizaj¹

Me anë të këtij punimi do të paraqesim rëndësinë e anëtarësimit të Republikës së Kosovës në Organizatën e Policisë Kriminale "INTERPOL". Republika e Kosovës është shteti më i ri në Evropë, kështu që me anëtarësimin e shtetit tonë në këtë organizatë mund të luftohet me lehtë terrorizmi, krimi i organizuar dhe të gjitha llojet e krimeve ndërkombëtare. Me rastin e anëtarësimit të shtetit tonë do të mundësohet shkëmbimi i informacioneve dhe analizimi i tyre për grupe të caktuara terroriste dhe kriminale. Pasi që Policia e Kosovës është trajnuar nga personeli profesional policor evropian dhe ai i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, do të bëhet një krah dhe aleat i rëndësishëm i kësaj organizate. Kështu që, në këtë punim do ta cekim rëndësinë e Republikës së Kosovës, përkatësisht Policisë së Kosovës, në dhënien e kontributit të saj në luftimin e përbashkët me shtetet anëtare të kësaj organizate në luftimin e terrorizmit dhe krimin të organizuar vendor dhe ndërkombëtar.

Fjalë kyç: polici, krim i organizuar, terrorizëm, informata, luftim i krimin.

¹ Dr. Kenan Idrizaj, Universiteti i Sarajevës, Fakulteti i Kriminalistikës dhe Shkencave të Sigurisë, Bosnjë dhe Hercegovinë/Faculty of Criminology and security science, Sarajevo, Bosnia-Hercegovina: kenan_idrizaj@live.com

The European Future of Albania and Kosovo as Western Balkan countries

Laura Agolli¹

Geographically, Western Balkan countries are located in the Southeast part of Europe and consist of 7 countries: Bosnia and Herzegovina, Croatia, Serbia, Montenegro, Macedonia, Albania and Kosovo. These countries have played an important role in history. At the moment of speaking, only Croatia is a member state of the European Union. Currently, Kosovo is a potential candidate for EU accession and Albania is considered as a candidate negotiating from March 2020. Albania, a country with a population of 2.8 million, has been an EU candidate country since 2014. Kosovo, signed the Association Agreement with the EU in April 2016. Both countries are characterized by high levels of corruption and political problems that should be considered in order to proceed further. This study tries to identify the strengths and potential challenges that pose an obstacle in terms of the EU accession process of these two Western Balkan countries and discuss potential solutions to the challenges that slow the pace for both Albania and Kosovo.

Keywords: EU, Albania, Kosovo, accession, Western Balkans

¹ Ma. Laura Agolli, Administratë Publike/Public Administration, Oakland University, Rochester, Michigan, USA: lagolli@oakland.edu

Identiteti vs. qytetërimi; një qasje teorike dhe empirike

Lekë Sokoli¹

Në fokus të kësaj konference është edhe 'identiteti'. Dhe pikënisje e këtij punimi janë rezultatet e marra nga dy sondazhe. I pari me studentë të shkencave sociale e humane të nivelit master të dy universiteteve, UT dhe UAMD. Objekt i sondimit 'face to face' ishte pikërisht kuptimi (ose në të kundërt, moskuptimi) që kanë studentët e ciklit të dytë të studimeve rreth konceptit "identitet" si dhe raportit të identitetit me qytetërimin. I dyti është një sondazh online i realizuar me shqiptarë që jetojnë në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi e Diasporë (n=397), mbi një gamë të gjerë çështjesh, ndër të cilat përfshihen edhe (a) perceptimi mbi ndjenjën e identitetit kombëtar shqiptar (në katër shkallë) dhe (b) perceptimi i shqetësimit për kristalizimin e ndonjë identiteti tjetër në botën shqiptare (si "identiteti kosovar" p.sh.), jashtë identitetit shqiptar (sërisht në katër shkallë). Nga të dhënat rezulton se ka një pështjellim në kuptimin mbi identitetin, mbi përbërësit e tij, mbi peshën specifike të këtyre elementeve përbërëse në ndërtimin e identitetit, në kuptimin e kategorive të ndryshme: "Identitet Evropian", "Qytetërim Evropian" e "Bashkim Evropian". Në veçanti, rezulton një keqkuptim i madh në raportin midis identitetit (si një pronë e një populli krijuar "me dyer të mbyllura" që as jepet, as merret, as tjetërsohet), me qytetërimin (si një arritje "me dyer të hapura" që merret, jepet apo edhe tjetërsohet). Pra, a ka probleme për shqiptarët dhe jo vetëm, në "lojën me dyer të hapura", siç është ajo që imponojnë proceset integruese dhe globalizuese? Dhe, së fundi, perceptimi shqetësues që konstatohet lidhur me "identitete të tjera 'legjitime'" brenda identitetit kombëtar shqiptar, dikton nevojën e studimit të "çështjes shqiptare" dhe trajtimit të saj me qartësi e pragmatizëm (sa nuk është tepër vonë).

Fjalë kyç: identitet, qytetërim, integrim, qasje teorike, qasje empirike.

¹ Prof. dr. Lekë Sokoli, Instituti Shqiptar i Sociologjisë/Albanian Institute of Sociology, Tirana, Albania: sokoli53@gmail.com

Creating a video word cloud in EFLT

Lela Ivanovska¹ & Isa Spahiu²

The use of technology in education in general and in language teaching in particular has lots of opportunities for students and classroom. Such opportunities are word clouds as graphical representations of word frequency, which are shown in different sizes or colors according to their importance. The more frequently a word appears in the text, the larger its size in the visual design. The user can alter the style, colors and layout of the word collage. Using word clouds facilitate interactive information sharing, collaboration and learning. These popular forms of data visualization. make students more active and creative during the learning process. Recent research in English foreign language teaching has suggested using word clouds in teaching language skills – reading, writing, speaking and listening. In addition word clouds can help students in creating learning motivation, setting up an interactive classroom activity, to react to topics and produce their own understanding based on that reaction. This study aims to introduce how we can use word clouds in English foreign language classroom to bridge the comprehension gap with authentic video. It includes suggestions for sources of authentic video as well as some examples of activities we can create using Skim Thru app to extract word clouds from the video script.

Keywords: word clouds, authentic video, English language classrooms, teaching comprehension

¹ Prof. asst. dr. Lela Ivanovska, Faculty of Information and Communication Technologies, Bitola, North Macedonia: lela_bt@yahoo.com

² Prof.ass. dr. Isa Spahiu, Fakulteti i gjuhëve të huaja/Faculty of foreign languages, Prishtina, Kosovo: isa.spahiu@aab-edu.net

The Demographic, Socioeconomic, and Political Determinants of Migration Aspirations Among Young People in Kosovo

Linda Abazi Morina¹

Many factors are believed to cause an increase in migration intentions among youth, especially those from developing countries. The current study examines the effect of several demographic, socioeconomic, and political determinants on young people's intention to migrate. Participants were 1200 young people in Kosovo, ages 14 to 29 years old. Applying a multinomial logistic regression, the findings showed that being unmarried and not employed was a significant predictor of migration aspiration. In contrast, age, gender, and residency (rural and urban) were not correlated with higher wishes to migrate. Low national pride was one of the strongest predictors of migration aspiration among youth. As such, those who are less proud of the country showed significantly stronger aspirations to migrate. The results of this study didn't point toward a significant relationship between political discontent (more precisely lack of trust in the national government and dissatisfaction with democracy) with a higher wish to migrate. Hopes for personal future were not a significant predictor, whereas those who reported higher pessimism about the country's future showed significantly higher aspirations to migrate. Lastly, young people who have volunteered over the last twelve months showed significantly higher aspirations to migrate, whereas voting in the next national election was negatively correlated with migration aspirations. The article concludes with a discussion on how these findings can (a) advance understanding of the impact of social, economic, and political factors on migration aspiration among youth and (b) inform efforts and strategies to prevent uncontrolled mass migration among youth.

Keywords: migration aspirations, young people, Kosovo

¹ Dr. Linda Abazi Morina, Kolegji AAB/AAB College, Prishtina, Kosovo: lindaabazi@gmail.com

The Diaspora vote important for the national development of Albania

Luljeta Mersinaj¹

The Diaspora of Albania has been and continues to be a reserve Albania, another Albania, a real Albania which has played a very important role in specific historical periods. Diaspora and sense of belonging are significant features of the community. Immigrants are usually active in relation to the well-being of the community, but also of the homeland, being willing to return if the needs of the country dictate. This article aims to explore the challenges faced by immigrants (diaspora), as well as the Albanian government, to enable the right to external voting (absentee ballots), their fellow citizens, for the first time in Parliamentary elections of April 25, 2021. For a country like Albania, involvement in the political process is an opportunity to increase its sense of identity around the world. Voting is the most basic form of political participation and the best way to hear the voice of the Albanian diaspora. Albania thus guarantees the right to vote to its citizens, who want to vote within the territory of the country, as a constitutional and legal right, to express their political will.

Keywords: Albania, Diaspora, vote, belonging, constitution, political will

¹ Ma. Luljeta Mersinaj, European University of Tirana, Tirana, Albania:
mersinajluljeta@gmail.com

Sistemi financiar dhe bankar në Shqipëri pas rënies së regjimit komunist

Malvina Kosova¹

Ndryshe nga ekonomitë e tjera në zhvillim, natyra dhe burimet e aktivitetit bankar shqiptar janë përgjithësisht të mbështetura në burime të brendshme, të tilla si depozitat që sektori privat dhe individët kanë vendosur në sistemin bankar. Po kështu, autentik për ekonominë shqiptare ishte edhe mekanizmi i transmetimit të krizës në sistemin financiar. Këto veçori kushtëzohen jo vetëm nga zhvillimet dhe ngjarjet ekonomike të periudhës së krizës, por edhe nga një sërë fenomenesh që kanë dominuar jetën ekonomike në fazat e para të tranzicionit drejt ekonomisë së tregut dhe që kanë lënë një kujtesë të fortë tek individët dhe bizneset shqiptare. Një nga problemet kryesore të tranzicionit në Shqipëri është pikërisht shkalla e lartë e euroizimit real të ekonomisë shqiptare, i cili shfaqet fuqishëm dhe drejtpërdrejt në një shkallë relativisht të lartë të euroizimit financiar. Të gjitha këto zhvillime dhe mekanizmi i përgjithshëm ekonomik e financiar që i lidh ato, përbëjnë një interes të veçantë për Bankën e Shqipërisë jo vetëm nga këndvështrimi akademik, por më së pari dhe mbi të gjitha në funksion të rolit të saj si mbikëqyrës i stabilitetit financiar dhe si rregullator i aktivitetit të sistemit bankar.

Fjalë kyç: sistem bankar, tranzicion, euroizim, Banka e Shqipërisë, stabilitet financiar.

¹ Ma. Malvina Kosova, pedagoge/lecturer at the University College Wisdom, Tirana, Albania: Malvina.kosova@gmail.com

An Expression of Resistance in Naming. A case study of Albanian anthroponyms in Kosovo during the 1990s resistance

Marika Butskhrikidze¹

Human creativity has no limits and people of different ethnic groups express it through different activities such as cooking, singing, dancing, clothing, writing, painting, etc. I believe one of the distinguished areas where Kosovar Albanian creativity is prominent, is naming.

I have spent the last fourteen years teaching at various private colleges in Prishtinë, the capital city of Kosova. At the beginning, it surprised me that the organization of students' lists was based on the alphabetical order of people's first names, rather than surnames which is widely practiced in western countries. Later, I realized that the reason for that is a huge diversity of first names reflecting the whole history of this nation. The focus of this paper is on the given names that have emerged not as a result of religious or cultural influence, but as a result of the resistance against Serbian occupation, especially during the 90s. The names are classified and analyzed according to three major themes: patriotism, traditionalism and a spirit of resistance. The study of female and male given names (e.g. Atëdhe, Fitore, Grevista, Guxim, Heroldina, Herolinda, Tonibler, Kushtrim, Liberta, Luftetar, Çlirim, Shpetim, Liridon, Ilirjana, etc.) of children born during that period demonstrate Kosovar Albanian attitudes and dispositions towards the occupants and shows very vividly how names carry history with them. We compared first names given during the 80-90s with ones in the 70s and afterward in the 2000s, to illustrate the difference between those periods and demonstrate how Kosovar anthroponyms are iconic of the time/events and reflective of national identity.

Keywords: Albanian anthroponyms, identity, iconicity, Kosovo

¹Prof. dr. Marika Butskhrikidze, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja/faculty of foreign languages, AAB College, Prishtina, Kosovo: marika.butskhrikidze@aab-edu.net

Kultura politike totalitare si pengesë e proceseve europianizuese të Shqipërisë

Matilda Pajo¹

Procesi i integritimit të Shqipërisë në Bashkimin European ka qenë përparësia e parë e shtetit shqiptar që prej rënies së regjimit komunist. Rrugëtimi i Shqipërisë në Bashkimin European ka qenë i vështirë dhe me mjaft sfida, sikurse dhe ecuria e brendshme e saj drejt demokratizimit. Në këtë studim do të përqendrohemi në ndikimin që ka kultura politike totalitare në pengesën e procesit integruar të Shqipërisë në BE. Ky punim mbështetet në një qasje cilësore. Kultura politike është korpusi i besimeve, qëndrimeve, vlerave që ka qytetari si anëtar i shoqërisë dhe raportin e tij me sistemin politik. Kongruenca e plotë midis kulturës politike dhe natyrës së sistemit politik të një vendi të caktuar, ndihmon në pranimin shoqëror e politik të reformave të brendshme e të jashtme që një shtet kryen. Mungesa e kësaj kongruence sjell jo vetëm vonesë, sfida e problematika të ndryshme sociale, politike e ekonomike, por edhe mungesë të një dakordësie të pranuar shoqërore në lidhje me tema me rëndësi vitale për shoqërinë. Në rastin e Shqipërisë, kultura politike totalitare ka frenuar ndërtimin e një shoqërie demokratike dhe procesin europianizues të Shqipërisë postkomuniste. Në vitin 2014 Shqipëria mori statusin e vendit kandidat dhe prej atëherë procesi negociues drejt anëtarësimit të mëtejshëm duket sikur ka stagnuar. Shqipëria nuk arriti të marrë konfirmimin për negociatat për anëtarësim pas tri herë refuzim nga BE. Punimi kërkon të shpjegojë rolin ende të pranishëm të mbetjeve totalitare në zhvillimet e sotme shoqërore e politike të shtetit shqiptar, duke u përqëndruar në mënyrë të veçantë në ecurinë e Shqipërisë me Bashkimin European. Në fund, punimi përpiqet t'i japë një interpretim të ndryshëm për të shpjeguar sfidat dhe kontradiktat aktuale me të cilat ballafaqohet shoqëria shqiptare postkomuniste në Shqipëri në lidhje me rrugëtimin europianizues të saj.

Fjalë kyç: kulturë politike, totalitarizëm, demokratizim, Bashkimi European.

¹ Dr. Matilda Pajo, Fakulteti i Administratës Publike/Faculty of Public administration, AAB College, Prishtina, Kosovo: matilda.pajo@aab-edu.net

Periudha e pandemisë (Covid-19) dhe transformimi i hapësirave publike

Medina Spahiu Çeko¹

Hapësirat publike janë ikona të identitetit urban. Elementet e identitetit të hapësirave publike janë sheshet, zonat tregtare, xhamitë, rrugët dhe sheshet. Në studim është përdorur metoda e hulumtimit cilësor bazuar në standarde botërore si dhe konceptprojekte të propozuara dhe të realizuara. Në secilin komunitet dhe kulturë hapësirat publike kanë një perspektivë unike: grekët përmendet me Agorën, romakët me Forumin, osmanët me Çarshinë dhe Bedestenin. Ndërkaq, në ditët e sotme, hapësira publike konsiderohen qendrat tregtare, hapësirat rekreative, hapësirat e parkimit etj. Konsideruar gjithmonë rëndësinë e krijimit të hapësirave publike për rekreacion, gjë që ndikon pozitivisht në cilësinë e jetës, hapësirat publike të mirorganizuara janë bërë një domosdoshmëri për shoqërinë. Kohët e fundit, kjo çështje ka fituar më shumë rëndësi për shkak të periudhës së pandemisë Covid-19. Ky studim është vlerësuar në lidhje me rekreacionin e hapësirave publike gjatë periudhës së pandemisë së viteve të fundit. Në fillim të studimit, nisur nga përkufizimet e hapësirës publike urbane, më pas është treguar për standardet e hapësirave publike urbane krahasuar me standardet e reja të pandemisë. Krijimi i distancës sociale, rekomanduar nga Institucionet e Shëndetësisë, ndryshon dhe standardet urbane për hapësira publike. Në studim jepen edhe shembuj konceptesh nga bota të adaptimit të hapësirave në bazë të standardeve të reja, rrjedhojë e Pandemisë.

Fjalë kyç: rrjete sociale, reklamë, komunikim asimetrik, medie të reja, konsumator.

¹ Medina Spahiu Çeko, PhD Cand., AAB College, Prishtina, Kosovo:
medinaspahiuceko@gmail.com

Vlerësimi i hapësirës fizike urbane për persona me aftësi të kufizuara

Medina Spahiu Çeko¹

Çështja e qasjes ka ekzistuar nga ekzistenca njerëzore. Përshtatshmëria e objekteve arkitekturale për persona me aftësi të kufizuara është një problem jo vetëm në Kosovë, por edhe në të gjithë rajonin dhe më gjerë. Si i tillë, ky problem ka filluar diskutimin nga dekadat e fundit, me vlerësimin e zërave për të drejta të barabarta të njeriut, pavarësisht nga aftësitë fizike që një person mund të ketë ose jo. Fatkeqësisht, faktorët përcaktues në këtë situatë janë nga natyra të ndryshme. Nga kjo pikëpamje, roli i arkitektit është mjaft i rëndësishëm në procesin e zbatimit të standardeve të nevojshme. Përderisa gjatë projekteve të reja arkitekturale përshtatshmëria për persona me aftësi të kufizuara nuk kërkon pothuajse fare kohë dhe kjo mund të aplikohet menjëherë, pasi nuk kërkon investim shtesë, përshtatja e objekteve të reja kërkon kohë dhe investime shtesë. Aftësitë e kufizuara mund të akomodohen në tri grupe: persona me aftësi të kufizuara në lëvizje, persona me dëmtime në të parë dhe personat me dëgjim të dëmtuar. Pengesat e zakonshme, për njerëzit me aftësi të kufizuara, janë: komunikimi urban, pengesa në ndërtesa publike dhe ndërtesa të tjera, dizajn i përshtatshëm për elementet urbane dhe enteriere. Kjo do të thotë që duhet të sigurohet qasje në të gjitha ndërtesat dhe përdorim i ndërtesave në mënyrë të pavarur (pa përcjellje) nga e gjithë popullsia e personave me aftësi të kufizuara.

Fjalë kyç: aftësi e kufizuar, dizajn universal, barrierë arkitektonike, qasshmëri për të gjithë.

¹ Medina Spahiu Çeko, PhD Cand., AAB College, Prishtina, Kosovo:
medinaspahiuceko@gmail.com

EU Common Foreign and Security Policy - before and after Lisbon

Mersel Bilalli¹

In parallel with the specific interests of the EU member states, the common EU foreign and security policy has become, after the economy, one of the most important issues of EU domestic policy. One of the main goals of the EU's foreign policy is its aspiration to speak with one voice, that is, for all 27 member states to respond to a specific foreign policy problem in a unified way. But numerous examples from international practice show that the EU is still inferior in this respect. The golden years in terms of a somewhat effective coordination in the construction of the common EU foreign and security policy were especially the years 2002-2013. But in recent years we have serious institutional setbacks in this regard. The causes are numerous and well known. The purpose of this paper is a detailed analysis of the existing situation and the factors that determined this serious stagnation in this area, but also what needs to be done so that the process can be oriented to a cohesive direction.

Keywords: Foreign policy; Common security policy; European Union;

Coordination

¹ Prof. dr. Mersel Bilalli, Fakulteti Juridik/Faculty of Law, AAB College, Prishtina, Kosovo: mersel.bilalli@aab-edu.net

The importance of English in Higher Education in Kosovo

Mirsad Suhodolli¹

Learning English and consequently teaching it has become a necessity not only in the primary and secondary education but also in the higher education in Kosovo and abroad. This is seen in many instances when students who wish to enroll in universities or pursue their master's degree, in our case in Kosovo, are required to master a certain level of English language. This imposes more effort on professors in order to help students achieve their goals be it academic or else for the labor market for finding a job. Furthermore, professors do not only need to teach English included in a particular subject but also be up-to-date with the changes in teaching methodology so as to help students meet the requirements for academic world as well as for the labor market regardless of what the students are majoring in. The research paper to follow will explicitly give more clarification on the importance of English in higher education in Kosovo but in European context by also comparing it to the research conducted by other researchers Europe-wide. This further means that various works will be carefully referred to and further explained by giving new insights into teaching and learning English in Kosovo. Apart from this, the paper is also based on the researcher's experience as a university professor and previously as a secondary school professor which lays the ground for more reliable research.

Keywords: English, teaching , learning / acquiring, method

¹ Dr. Mirsad Suhodolli, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja/Faculty of foreign languages, AAB College, Prishtina, Kosovo: mirsad.suhodolli@aab-edu.net

What is the external business perception by foreign investors? A study of foreign firms in Kosovo

Nakije Kida¹

The access of foreign investors to the business environment in developing countries is still unclear. Therefore, the purpose of the research is to provide perceptions of foreign investors about the external environment of Kosovar business. Many factors, including demographic, economic, political, institutional, socio-cultural, legal system, ethical attitudes, xenophobia and networking, are involved in helping to find research issues. The empirical research was conducted through structured questionnaires distributed to 70 foreign investors, randomly selected throughout Kosovo. Primary quantitative data processing was done with Excel, using descriptive statistical analysis. The findings of the study suggest that the political-institutional factors and the legal system are considered as risks related to the activity of foreign investors in Kosovo. While economic factors are partially attractive, socio / cultural factors, ethical attitudes, xenophobia and networking are fully attractive. However, the Kosovar business environment is still attractive to foreign investors, so Kosovar policymaking needs to accelerate the regulation of legal and political / institutional mechanisms in favor of foreign investment.

Keywords: External business environment, economic factors, legal system, xenophobia, foreign investors.

¹ Prof. ass. dr. Nakije Kida, Fakulteti Ekonomik/Faculty of Economics, AAB College, Prishtina, Kosovo: nakije.kida@aab-edu.net

Sfidat e Marrëveshjeve mbi Integrimet e Ballkanit Perëndimor në BE

Nazmi Iballi¹

